



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Nr. \_\_\_\_ prot.

Prrenjas, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[Data 04.06.2024]

**Drejtuar:**

Operatori ekonomik “TIMAC” shpk me nipt M01706003U, me adresë: Tirana Industrial Park, Nr.37.  
Rr. Egnatia, Kashar, Tirane, me administrator Znj.Arjeta Puca.

**Procedura e prokurimit/lotit:** Procedure e hapur e thjeshtuar - mall

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** REF-02496-04-24-2024

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje kamioni për mbetjet urbane (mjete teknologjik)”

**Fondi limit total:** 8,754,458 (tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Afati kontrates:** 60 dite nga data e nënshkrimit të kontratës .

**Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):** Buletini i Njoftimeve Publike [Nr.22 date 29.04.2024].

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “CompiTel shpk ” shpk M31417021V

Vlera 6.900.000 (Gjashte milionë e nëntëqind mijë) leke pa tvsh.

2. Operatori ekonomik “TIMAC”shpk M01706003U

Vlera 8,490,000 (tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

3. Operatori ekonomik “TIRES-R” shpk M12413025K

Vlera :8,630,000 (tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh.

- Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “CompiTel shpk ” shpk M31417021V

Vlera 6.900.000 (Gjashte milionë e nëntëqind mijë) leke pa tvsh.

Arsyet e mëposhtme :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga operatori ekonomik “CompiTel” shpk u konstatua se operatori ekonomik “CompiTel” shpk nuk ka arritur të paraqes dokumentacionin e plot dhe të sakt për të dëshmuar plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të vecanta dhe për kualifikim, me konkretisht :

1. Nuk ka paraqitur Vërtetimin se Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Në kundërshtim me Nenin 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, **“b”**, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>, si dhe në kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.*

2. Operatori ekonomik nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; (konkretisht për muajt Shkurt dhe Mars).

Operatori ekonomik ka dorëzuar vërtetim me nr. T.10143318 date 13.03.2024 për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, ku vërtetohet se ka paguar kontributeve të sigurimeve shoqërore **vetëm për muajin Janar 2024**.

Operatori ekonomik **nuk ka paguar të gjitha detyrimet** për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; (konkretisht **nuk ka paguar për muajt Shkurt dhe Mars**), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 11, të Ligjit Nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në kundërshtim të Nenit 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, **“dh”**, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>, si dhe në kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.

3.Operatori ekonomik “CompiTel” shpk, nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 07.05.2024, detyrimet e energjisë elektrike për **muajin mars 2024** janë të maturuara në kuptim të përcaktimeve ligjore, afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 30.04.2024. Nëse i referohemi vërtetimit të OSHEE – 2024-7735974-YD date 12.04.2024 rezulton se muaji MARS 2024 është i pa likuiduar. Sipas këtij vërtetimi debie rezulton se operatori ekonomik COMPITEL rezulton të ketë në total 0 (zero) leke detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 12.04.2024, **pa përfshire faturen koherente të muajit MARS 2024.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 07.05.2024 dhe në këtë mënyrë sipas përcaktimit ligjor shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin MARS e cila mund të bëhet deri në datën 30.04.2024 (detyrime këto të muajit MARS të cilat janë të maturuara) nuk është realizuar.

Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (07.05.2024), KVO gjykon se, nuk ka plotësuar kriterin lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

-Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 7, gërma “a”, përcaktohet se : Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) **operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.**

-Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.109, datë 21.10.2011 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”

- Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 2, gërma “e”, **përcaktohet : se operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;** (sipas formularit të vetdeklarimit )

-Neni 26 pika 6 përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, **“e”**, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>3</sup>.

Në kundërshtim dhe me piken 1 gërmën “ e” Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.

4.Në pikën 2/a të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit është kërkuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se ky dokument nuk është paraqitur fizikisht por vetëm në SPE, në kundërshtim me Nenin 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, **“e”**, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>4</sup>.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe si rrjedhojë oferta e operatorit ekonomik “CompiTel” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “TIMAC”shpk me nipt M01706003U me adresë: Tirana Industrial Park, Nr.37. Rr. Egnatia, Kashar, Tirane, me administrator Znj.Arjeta Puca dhe vlere te ofertes 8,490,000 (tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme e procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*Bashkia Prrenjas, Rruga Skenderbej, Sektori Juridik dhe i prokurimeve*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 8,630,000 (tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Pranoi: Z. Çekrezi  
Konceptoi: M.Rira  
A.Kopaçi

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**NURI BELBA**